

Datë 11.05.2026

KËRKESË

KËRKUES: Erion Veliaj, i biri i Luanit dhe i Shqiponjës, lindur në 17.12.1979, në Tiranë dhe aktualisht në IEPV Durrës, Lagjja nr. 17, ish-këneta, Durrës. Përfaqësuar nga Av. Plarent Ndreca.

DREJTUAR: ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË:

Znj, Mirela P. BOGDANI

Z. Erind MERKURI

Z. Erion FEJZULLA

Z. Vatë STAKA

Z. Moisi DUDA

Z. Olger EMINAJ

Znj. Ledina RIZA

Znj, Arta MANDRO

Z. Sokol STOJANI

Z. Zeqir HODA

Adresa: Rruga "Ana Komnena", Godina " Poli i Drejtësisë" , Tiranë, Shqipëri

OBJEKTI: KËRKESË PËR INFORMACION

Të nderuar,

Nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është duke u gjykuar kërkesëpapia me palë dhe objekt si në vijim: paditës: Erion Veliaj, si dhe Bashkia Tiranë; i paditur: Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ols Dado; si dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë; objekti: *“1. Konstatimi i pavlefshmërinë absolute të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 5936, datë 17.11.2008, për emërimin e z. Ols Dado në detyrën e prokurorit të Republikës së Shqipërisë. 2. Detyrimin e KLP të marrë vendim lidhur me përfundimin e statusit të magjistratit të z. Ols Dado dhe përfundimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës prej tij. 3. Ngarkimin e të paditurve me shpenzimet gjyqësore.”*

Gjatë zhvillimit të këtij gjykimi, pas paraqitjes nga përfaqësuesja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë të dokumentacionit përkatës administrativ, u evidentua një rrethanë me rëndësi të drejtpërdrejtë për mënyrën e trajtimit institucional të kërkesës sonë lidhur me konstatimin e pavlefshmërisë absolute të dekretit të emërimit të z. Ols Dado dhe deklarimin e përfundimit të statusit të tij si magjistrat. Konkretisht, nga dokumentacioni i administruar në gjykim nuk rezulton që kjo kërkesë të jetë marrë në shqyrtim nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë si organ kolegjal kushtetues. Përkundrazi, rezulton se lidhur me këtë kërkesë ka vepruar vetëm nënkryetari i KLP-së, z. Erind Gërmenji, i cili me shkresën nr. 413/3 prot., datë 11.03.2025, na ka informuar se “KLP shqyrtoi kërkesën tonë” për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të dekretit të emërimit të z. Ols Dado dhe për deklarimin e përfundimit të statusit të tij si magjistrat

Megjithatë, nga provat e administruara në gjykim rezulton se përmbajtja e shkresës së sipërcituar nuk i korrespondon realitetit procedural të trajtimit të kësaj kërkesë. Konkretisht, nuk rezulton që kërkesa jonë të jetë shqyrtuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë si organ kolegjal, por vetëm nga nënkryetari i tij, z. Erind Gërmenji, i cili në këtë shkresë ka mbajtur edhe qëndrim mbi themelin e kërkesës, duke arsyetuar se nuk mund të konstatohej pavlefshmëria e pretenduar për shkak se z. Ols Dado kishte kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar. Ky element merr rëndësi të drejtpërdrejtë juridike në kushtet kur neni 66 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikon se kompetenca për vendimmarrjen lidhur me përfundimin e statusit të magjistratit i takon Këshillit të Lartë të Prokurorisë si organ kolegjal. Për rrjedhojë, në kushtet kur nga dokumentacioni i administruar në gjykim nuk rezulton ekzistenca e një shqyrtimi apo vendimmarrjeje kolegjiale të KLP-së mbi këtë kërkesë, krijohet një mospërputhje e dukshme ndërmjet përmbajtjes së shkresës së datës 11.03.2025 dhe procedurës që rezulton e ndjekur në praktikë, duke e kthyer shkresën në fjalë në një akt *nul*.

Referuar dokumentacionit të administruar në gjykim dhe autorizimit të paraqitur në seancën e fundit gjyqësore, rezulton se përfaqësuesja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, zj. Danja Hobdari, është paraqitur në gjykim pa ekzistencën e një vendimmarrjeje kolegjiale të KLP-së lidhur me këtë çështje. Në këto kushte, përfaqësimi procedural i ushtruar prej saj rezulton i mbështetur vetëm mbi shkresën e datës 11.03.2025 të nënshkruar nga nënkryetari i KLP-së dhe jo mbi një qëndrim institucional të miratuar nga organi kolegjal kushtetues apo në emër të tij. Kjo situatë tregon qartë se përfaqësimi në gjykim nuk mbështetet mbi një qëndrim apo vendimmarrje kolegjiale të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, por vetëm mbi një shkresë të firmosur nga nënkryetari i tij. Për rrjedhojë, edhe qëndrimet dhe argumentet e

parashtruara në gjykim nga përfaqësuesja e institucionit rezultojnë të pambështetura në një mandat institucional të miratuar nga organi kolegjal kushtetues.

Ndodhur në këto kushte, kërkojmë nga ana juaj të na informoni nëse keni qenë në dijeni të faktit se z. Gërmenji ka marrë në shqyrtim dhe ka vendosur personalisht lidhur me përfundimin e statusit të magjistratit të z. Ols Dado, për shkak të mospërmbushjes së kritereve ligjore për emërimin e tij, duke i hequr kompetencën Këshillit të Lartë të Prokurorisë për të marrë një vendim kolegjal mbi kërkesën tonë.

Me respekt,

Erion VELIAJ

Përfaqësuar nga

Av. Plarent NDRECA